

Afrim Brahimaj ka përfunduar studimet e larta në Universitetin e Tiranës në Ekonomi Politikë, si dhe ka vazhduar me studime pas universitare në Financë Bankë dhe Master në Administrim Publik (MPA).

Me një eksperiencë të gjerë profesionale që shtrihet për më shumë se tri dekada, duke filluar nga pozita e tij aktuale si Drejtor i Drejtorisë së Privatizimit në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, që e mban që nga shkurt 2024. Para kësaj, ai ka drejtuar Drejtorinë e Privatizimit dhe Shitjes në Ministrinë e Financave, duke kontribuar në proceset e privatizimit të institucioneve publike. Po ashtu, ai ka qenë Këshilltar i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK) nga prilli 2020 deri në tetor 2023, duke ofruar ekspertizë në çështje ligjore dhe ekonomike.

Më herët ka mbajtur gjithashtu pozita të rëndësishme në sektorin bankar si Drejtor Dege dhe ka kontribuar në ngritjen dhe konsolidimin e agjencive bankare. Përvoja e tij si Zv. Drejtor i Përgjithshëm Operacional në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve tregon aftësitë e tij në menaxhimin e operacioneve dhe organizimin e aktiviteteve.

Përveç përvojës menaxhuese, Afrimi ka marrë pjesë në konferenca dhe seminare ndërkombëtare, duke prezantuar tema si privatizimi i ndërmarrjeve publike dhe zhvillimin e aftësive të shitjes dhe negociatave në bankat tregtare.